



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1194 prot.

Tiranë, më 30. 07. 2019

V E N D I M

Nr. 102, Datë 30. 07. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 46, datë 16.04.2018, e shtetasit A. B., kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të bindjeve politike*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të ambulancës, prej 30 vitesh. Në vitin 2013, me Urdhër Nr. 1, datë 19.04.2013, të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, është larguar nga puna pa shkaqe të justifikuara, konstatuar ky fakt edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Mbështetur në Urdhërin Nr. 33, datë 18.12.2013, të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, është bërë sërish emërimi i tij në pozicionin e mëparshëm të punës, pozicion të cilin e ka mbajtur deri më datë 12.04.2018.

Në muajin Janar 2018, me emërimin në detyrë të A. D., në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, ndaj ankuesit kanë nisur kontrole të herë pas hershme të punës. Gjithashtu, është ngritur një grup auditi i brendshëm i Shërbimit Spitalor Skrapar, i cili ka konstatuar abuzime të ankuesit, në konsumin e karburantit dhe mos kryerjen e shërbimeve të autoambulancës. Në këto kushte, me vendimin Nr. 25, datë 12.04.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me të. Sipas ankuesit, secila autoambulancë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar edhe ajo me të cilën ai punonte, përdorej nga 2 shoferë me sistem turni 24-orësh. Pas kontrollit të auditit të brendshëm, pavarësisht se përgjegjës duhej të ishin të dy drejtuesit e autoambulancës, ndaj kolegut të tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Me largimin e tij dhe dy drejtuesve të

¹ Referuar Kartës së Anëtarësimit Nr. 5098 të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim

tjerë të autoambulancave nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, janë emëruar punonjës të rinj të cilët nuk plotësojnë kriteret e punësimit.

I ndodhur në këtë situatë, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi i tij gjatë procedurave për largimin nga puna, pasi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nuk lidhen me konstatimet e bëra nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, por me bindjet politike të tij, të kundërta me Drejtorin e Shërbimit Spitalor Skrapar.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar dhe të rekomandimin e rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 46, datë 16.04.2018 të A. B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

1. Me anë të shkresës me nr. 518/1 Prot., datë 19.04.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, lidhur me ankesën bërë nga A. B.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresave³ Nr. 166 prot., datë 14.05.2018 dhe Nr. 195, datë 04.06.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, ndër të tjera informoi Komisionerin se: *“...Në muajin Janar 2018, me emërimin e drejtuesit të ri të Shërbimit Spitalor Skrapar, janë bërë kontrolle periodike për të gjithë punonjësit, lidhur me zbatimin e rregullores dhe funksionimin sa më të mirë të këtij institucioni. Janë konstatuar shkelje të ndryshme dhe janë marrë masa disiplinore ndaj tyre. Nisur nga këto shqetësime në sektorin e transportit u ngrit një komision i posaçëm për verifikimin e konsumit të karburantit dhe kontrollin teknik për të gjithë mjetet që kanë kryer shërbimet gjatë muajve nëntor-dhjetor 2017. Janë kryer kontrolle për të gjitha mjetet nga auditi i brendshëm, si dhe nga një firmë servisi automjetesh e licensuar. Në përfundim të këtij procesi do të bëjmë kallëzim penal ndaj personave që kanë shpërdoruar detyrën. Përsa i përket A. B., pas kontrollit të kryer rezultoi të kishte diferenca në konsumin e karburantit dhe nuk kishte kryer shërbimet e riparimit të autoambulancës, sipas procesverbalit dhe faturës së firmosur prej tij. Gjithashtu, A. B. i është dhënë vërejtje, pasi gjatë dorëzimit të automjetit tek shoferi tjetër, nuk ka bërë dorëzimin e çelësit rezervë të autoambulancës që kishte në përdorim dhe pas insistimit nga ana e drejtuesve të institucionit ka bërë dorëzimin e tij. Në përfundim të procedurës së kontrollit, ndaj A. B. është bërë kallëzim penal.”*

2. Në kushtet kur përgjigja e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, nuk ishte e plotë, bazuar në kërkesat e shkresës së nisur nga KMD, mbështetur në Urdhërin nr. 118, datë 13.06.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtij institucioni më datë 21.06.2018, për të administruar informacionin e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së A. B.

Grupi i inspektimit të Komisionerit, mori takim me Xh. Ll., me detyrë Nëndrejtorë Ekonomike e Shërbimit Spitalor Skrapar, T. S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit Spitalor dhe A. L., me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore.

Gjatë inspektimit, Xh. Ll. sqaroi se: *“Referuar situatës në të cilën, ambulancat gjatë kryerjes së shërbimeve kishin pësuar defekte, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, u pa e nevojshme ngritja e grupeve të auditit të brendshëm, për verifikimin e konsumit të karburantit dhe pjesëve të këmbimit të automjeteve. Duke qënë se autoambulancave u ishin kryer të gjitha shërbimet e nevojshme në muajt Nëntor-Dhjetor 2017, atëherë u verifikuan edhe një herë pjesët e ndërruara. Në rastin e A. B., grupi i auditit të brendshëm konstatoi abuzime në konsumin e karburantit dhe në pjesët e këmbimit të autoambulancës që kishte në përdorim. Pretendimi i A. B., se largimi i tij nga puna është bërë për shkak të bindjeve politike nuk qëndron, pasi procedurat për largimin nga puna, janë kryer referuar shkeljeve të konstatuara.”*

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 518/2 prot., datë 18.05.2018 dhe Nr. 518/3 prot., datë 11.06.2018

Nga ana e përfaqësuesve të Shërbimit Spitalor Skrapar, u sqarua se nuk kishte një dokument a procedurë të miratuar, lidhur me detyrat e drejtuesve të autoambulancave apo me procedurën se si bëhet tërheqja apo furnizimi i automjeteve.

Përsa i përket vlerësimit të punës për punonjësit e Shërbimit Spitalor Skrapar, u sqarua se nuk ishin kryer vlerësime pune për vitet 2015-2016-2017.

Gjithashtu, u sqarua se deri në datën 21.06.2018 ishin larguar nga detyra 4 (katër) drejtues automjetesh, 2 (dy) për shkak të shkeljeve të konstatuara nga auditi i brendshëm, 1 (një) për shkak të thyerjes së disiplinës në punë dhe 1 (një) është larguar me dëshirë nga puna.

Në funksion të trajtimit të ankesës së A. B., nga grupi i inspektimit të KMD-së, u administrua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e konsumit të karburantit dhe pjesëve të këmbimit.
- Rregulloren e Funksionimit të Shërbimit Spitalor Skrapar (miratuar në vitin 1998).
- Kopje të dokumentacionit të auditit të brendshëm, për verifikimin dhe kontrollin e kryer për autoambulanat e Shërbimit Spitalor Skrapar.
- Dosjet personale të punonjësve shofer në Shërbimin Spitalor Skrapar.

3. Referuar informacionit të dhënë në shkresat Nr. 166 prot., datë 14.05.2018 dhe Nr. 195, datë 04.06.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar më datë 27.04.2018, ka paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, kallëzim për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, ndaj A. B.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 981, datë 10.07.2018, kërkoi nga institucioni i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, informacion nëse është rregjistruar procedim penal ndaj shtetasit A. B. dhe në cilën fazë ndodhet procesi.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat sqaroi⁴ se, mbështetur në parashikimet e nenit 135 “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën” dhe nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si dhe referuar kallëzimit të paraqitur nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, ndaj shtetasit A. B. ka nisur procedim penal lidhur me këto vepra penale.

Në lidhje sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vlerësim të pretendimeve të ngritura nga shtetasi A. B., konstatoi se deri në përfundim të procesit të hetimit dhe vendimit të organeve përkatëse, Komisioneri nuk mund të kryente veprime hetimore dhe nuk mund të shprehet për konstatimin e situatës diskriminuese në veprimet e

⁴ Me anë të shkresës Nr. 1634/2, datë 11.07.2018

Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, pasi çështja po hetohej dhe shqyrtohej nga organi i prokurorisë.

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje ishte duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Berat, në mbështetje të nenit 66, pika 1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *“Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), **organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë**”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendim Nr. 155, datë 13.07.2018, pezulloi shqyrtimin e ankesës Nr. 46, datë 16.04.2018, të shtetasit A. B., deri në momentin që Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Berat të shprehej për çështjen në shqyrtim.

Me anë të shkresës⁵ Nr. 1097 prot., datë 11.07.2019, subjekti ankues vuri në dispozicion të KMD-së Vendimin Nr. 228, datë 14.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Berat, e cila është shprehur për: *“Pushimin e çështjes penale Nr. 228 rregj. Them., datë regjistrimi 13.05.2019, që i përket procedimit penal Nr. 306, datë 04.05.2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në ngarkim të shtetasit A. B. për veprat penale ‘Vjedhja duke shpërdoruar detyrën’ dhe ‘Shpërdorimi i detyrës’ të parashikuara në nenet 135 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak se fakti nuk ekziston”*.

Në këto kushte, pasi Gjykata e Rrethit Gjiqësor Berat u shpreh për çështjen dhe në mbështetje të nenit 68, pika 1/b të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *“1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme: ...b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi me procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Sipas informacionit dhe provave të administruara, ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të autoambulancës, prej 30 vitesh. Në vitin 2013, është larguar nga detyra që mbante, pa shkaqe të justifikuara, konstatuar ky fakt edhe nga Gjykata e Rrethit Gjiqësor Berat. Në fund të vitit 2013, është bërë sërish emërimi i tij në pozicionin e

⁵ Protokolluar pranë KMD-së i noterizuar nga shtetasi A. B. me Nr. 1152 Rep., datë 10.07.2019

mëparshëm të punës, si dhe nga ana e punëdhënësit i janë paguar të gjitha detyrimet lidhur me largimin pa shkaqe të justifikuara nga puna. A. B. gjatë detyrës së ushtruar, nga viti 2015 deri më datë 24.01.2018, ka patur në përdorim autoambulancën tip Volkswagen me targë AA 183 KY. Secila autoambulancë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar edhe ajo me të cilën ai punonte, përdorej nga 2 shoferë me sistem turni 24-orësh, pra nga A. B. dhe shoferi solidar ose i dytë, shtetasi Sh. D.

Me emërimin në detyrë të A. D., në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, me urdhërin datë 17.01.2018, të Drejtorit të Institucionit, autoambulanca tip Volkswagen me targë AA 183 KY, në përdorim të ankuesit, i kalohej në përdorim shtetasit A. A. Në këto kushte, më datë 24.01.2018, me anë të procesverbalit të mbajtur në prezencë të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar A. D., Përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit Spitalor T. S., Specialistes së Burimeve Njerëzore A. L. dhe shoferit Sh. D., autoambulanca me targë AA 183 KY, i është dorëzuar A. A., me të gjithë pajisjet në rregull, por në mungesë të njërit prej çelësave. Sipas procesverbalit, nga ana e Drejtorit të Institucionit dhe Përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit Spitalor, u kushtëzua largimi nga puna i A. B., nëse nuk dorëzonte çelësin e dytë të autoambulancës. Pas dorëzimit të çelësit, autoambulanca iu kalua shoferit A. A.

Përsa më lart, nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, me Urdhërin Nr. 1, datë 24.01.2018, A. B. i jepet masa disiplinore vërejtje për moszbatim të urdhërit, lidhur me dorëzimin e çelësit të automjetit, në momentin që është bërë kalimi i autoambulancës në përdorim të shoferit A. A.

a. Lidhur me kontrollin e konsumit të karburantit nga autoambulanca e A. B.

Në muajin Janar 2018, u ngritën grupe pune për verifikimin dhe konsumin e karburantit, si dhe për verifikimin nëse gjatë serviseve të kryera në muajt Nëntor-Dhjetor, janë ndërruar pjesët e këmbimit për autoambulanca, të deklaruara në procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe në faturat e shërbimeve.

Në këto kushte, më datë 17.01.2018, me Urdhërin Nr. 01, të tij, është ngritur “Komisioni i Kontrollit dhe Provës së Harxhimit të Karburantit të Automjeteve të Shërbimit Spitalor Skrapar”, i përbërë nga G. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, T. S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit Spitalor dhe A. N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit. Sipas këtij urdhëri, për verifikimin e konsumit të karburantit, fillimisht komisioni duhet të furnizojë automjetet me karburant, të konstatojë konsumin e çdo automjeti për një distancë kilometrike prej 100 km dhe në përfundim të hartojë procesverbalin mbi verifikimet e kryera, në mënyrë që të vendoset konsumi i çdo automjeti për periudhën në vijim të vitit 2018.

Në zbatim të Urdhërit Nr. 01, datë 17.01.2018, nga ana e Komisionit të konsumit të karburantit, fillimisht 4 (katër) autoambulanca e institucionit, u mbushën plot me karburant në distributorët përkatës, përkthyer një rrugë prej 100 km më datë 16.02.2018, u vendos që:

- Në bazë të procesverbalit, datë 17.01.2018, autoambulanca tip Volkswagen me targë AA 183 KY, me shofer Sh. D., rezultoi se norma e harxhimit për 100 km, do të jetë 11 litra.
- Në bazë të procesverbalit, datë 18.01.2018, autoambulanca tip Volkswagen me targë AA 241 CP, me shofer S. K., rezultoi se norma e harxhimit për 100 km, do të jetë 11 litra.
- Në bazë të procesverbalit, datë 24.01.2018, autoambulanca tip Mitsubishi me targë AA 163 BZ, me shofer K. K., rezultoi se norma e harxhimit për 100 km, do të jetë 11 litra.
- Në bazë të procesverbalit, datë 25.01.2018, autoambulanca tip Volkswagen me targë AA 159 BZ, me shofer A. B., rezultoi se norma e harxhimit për 100 km, do të jetë 13 litra.

Sipas informacionit dhe provave të administruara, me anë të Akt-Verifikimit Nr. 7, datë 28.04.2017, të specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor (drejtori nën varësinë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor), është ushtruar kontroll për periudhën 01.03.2014-31.03.2017, ndër të tjera edhe lidhur me shpenzimet dhe konsumin karburantit nga autoambulanat, në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Skrapar.

Mbështetur në gjetjet e Akt-Verifikimit të sipërcituar, konstatohet⁶ se gjatë periudhës për të cilën përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, kanë ushtruar kontroll, Komisioni i normativave, të konsumit të karburantit, të mjeteve të transportit dhe gjeneratorëve, të Shërbimit Spitalor Skrapar, përbehej nga: G. A., L. K. dhe T. S. Ky Komision gjatë kontrollit të normativave të konsumit të karburantit ka konstatuar:

- **Për autoambulancën tip Volkswagen, me targë AA 183 KY, ka konstatuar normativën e konsumit prej 14 litra në 100 kilometra. (3 litra më shumë konstatimi i bërë më datë 17.01.2018)**
- Për autoambulancën tip Volkswagen me targë AA 241 CP, ka konstatuar normativën e konsumit prej 12 litra në 100 kilometra. (1 litër më shumë konstatimi i bërë më datë 18.01.2018)
- Për autoambulancën tip Mitsubishi me targë AA 163 BZ, ka konstatuar normativën e konsumit prej 14.4 litra në 100 kilometra. **(3.4 litra më shumë konstatimi i bërë më datë 24.01.2018)**
- Për autoambulancën tip Volkswagen me targë AA 159 BZ, ka konstatuar normativën e konsumit prej 15.9 litra në 100 kilometra. **(2.9 litra më shumë konstatimi i bërë më datë 25.01.2018)**

Gjithashtu, përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, nga verifikimi i kilometrave të përshkuara, duke i llogaritur me normativën e

⁶ Faqja 3, e Akt-Verifikimit

harxhimit, ka rezultuar se justifikohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nga të gjithë shoferët e autoambulancave. Sasia e konsumit të karburantit, sipas Akt-verifikimit, justifikohet edhe mbështetur në të dhënat që GPS⁷-i i çdo autoambulance shënonte.

Përsa më lart, rezulton se G. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe T. S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit Spitalor, kanë qënë pjesë të komisioneve të kontrollit të normativave të konsumit të karburantit, gjatë viteve 2015-2016-2017-2018. Pra, nga tre anëtar që kanë patur komisionet, në këto vite 2 prej tyre kanë qënë punonjësit e sipërcituar. Referuar konstatimeve të tyre për kontrollin e normativave të konsumit të karburantit, nga viti 2015 deri në vitin 2017, ato kanë qënë të njëjta për secilën autoambulancë të Shërbimit Spitalor Skrapar, ndërsa për vitin 2018 ky komision, ka kryer sërish verifikimet përkatëse dhe ka konstatuar konsum më të ulët të karburantit vetëm për dy prej autoambulancave.

Një tjetër fakt, lidhur me konsumin e karburantit për mjetin që kishte në përdorim A. B., është dhe rekomandimi i datës 15.01.2015, lëshuar nga Kompania Classic (Distributor i Volkswagen), në momentin që është blerë autoambulanca tip Volkswagen, me targë AA 183 KY, në këtë kompani. Referuar këtij rekomandimi, konsumi i karburantit në katalogun e fabrikës (urban 9.9-10.2 litra, konsumi extra urban 7.6-7.8 litra), është vendosur ai minimal me makinë bosh, pa ngarkesë, pa kondicioner, madje edhe serbatori i mbushur përgjysëm. Në kushtet që përdoren të gjitha automjetet në vendin tonë dhe për më tepër autoambulancat, me cilësinë e karburantit, shpejtësinë relativisht të ulët të lëvizjes për shkak të trafikut dhe cilësisë së rrugëve, duke shtuar edhe faktin që janë të ngarkuara gjithmonë me peshën e pajisjeve, do të ketë një shmangie me rreth + 35- 45 %. Pra, në përfundim është përcaktuar konsumi i karburantit prej 14 litra në 100 kilometra.

Mbështetur në Urdhërin Nr. 13, datë 16.02.2018, të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, është krijuar Komisioni i Auditit të Brendshëm, i përbërë nga Xh. Ll., me detyrë Nën drejtor Ekonomike, N. D., me detyrë Specialiste Ekonomiste dhe M. P., me detyrë Operatore Kosto. Auditimi i Brendshëm, pavarësisht faktit që gjatë viteve të shkuara komisioni i konsumit të karburantit kishte përcaktuar se 4 (katër) autoambulancat normën e konsumit të karburantit e kanë patur më të lartë, për vitin 2018 ka konstatuar një normë konsumi që varion nga 1-3.4 litra më pak për secilin automjet. Për këtë, ka konstatuar përgjegjës vetëm A. B. për diferenca negative dhe asnjë nga shoferët e tjerë të Shërbimit Spitalor Skrapar.

Pavarësisht faktit që komisioni për normën e konsumit të karburantit, është mbështetur në fletë-udhëtimet dhe të dhënat e nxjerra nga GPS-ja e autoambulancave, për vitin 2018, nuk janë marrë parasysh këto të dhëna.

Gjithashtu, nga ana e përfaqësuesve të Shërbimit Spitalor Skrapar, është pohuar se vetëm për ankuesin janë konstatuar diferenca negative në konsumin e karburantit dhe nuk është

⁷ Ssistem elektronik i instaluar në çdo autoambulancë, i cili shënon sasinë e karburantit të furnizuar, konsumuar për kilometër etj.

paraqitur asnjë provë nëse për drejtuesit e tjerë të autoambulancave është kryer i njëjti verifikim.

Në përfundim të arsyetimit dhe provave të administruara, rezulton se karburanti i konsumuar nga ana e mjetit në përdorim të ankuesit, ka qënë bazuar në nivelin e përcaktuar nga Kompania “Classic”, e cila ka shitur automjetin.

b. Lidhur me ndërrimin e pjesëve të këmbimit të autoambulancës në përdorim të A. B..

Në vijim të kontroleve të ushtruara, Komisioni i Kontrollit të Karburantit të Automjeteve të Shërbimit Spitalor Skrapar, i përbërë nga T. S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit Spitalor, A. N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit, si dhe në prani të drejtuesve respektivë të autoambulancave, më datë 05.03.2018, janë kryer kontrollet pjesëve të këmbimit për automjetet e institucionit. Sipas provave të administruara, gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2017, autoambulancave të Institucionit të Shërbimit Spitalor Skrapar, i janë kryer shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes, tek një subjekt privat i licensuar.

Referuar faturës datë 13.10.2017 dhe Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim të automjetit me targë AA 183 KY, rezulton se Komisioni dhe personat që kanë marrë në dorëzim autoambulancën, pas kryerjes së shërbimeve përkatëse, ishin: T. S., A. N., A. B., A. C., me detyrë shofer dhe përfaqësuesi i Servisit, P. B.

Pas kontrollit të ushtruar më datë 05.03.2018, Komisioni në prani të shoferëve të 4 (katër) autoambulancave respektive, konstatoi se nuk i janë kryer të gjitha shërbimet, si dhe nuk i janë ndërruar pjesët e këmbimit, sipas faturave të tërhequra nga subjekti i cili ka kryer këto shërbime.

Në kushtet që A. B. ka qënë drejtuesi i automjetit që ka tërhequr automjetin nga subjekti që ka kryer shërbimet, me vendimin Nr. 25, datë 12.04.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me të. Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar më datë 27.04.2018, ka paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, kallëzim për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, ndaj A. B.

Mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, janë ngarkuar me përgjegjësi, janë larguar nga puna, si dhe janë kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, A. B. dhe shtetasi S. K., të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me pretendim largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

Sipas informacionit të administruar gjatë procesit të hetim-inspektimit dhe provave bashkëngjitur shkresës nr. 166 prot., datë 15.05.2018 të Shërbimit Spitalor Skrapar, evidentohet se për periudhën Janar 2018 deri aktualisht, janë larguar 4 (katër) shoferë të autoambulancave dhe janë emëruar 3 (tre) të rinj, nga të cilët:

1. Shtetasi G. M., me arsim të mesëm dhe kategori të lejes së drejtimit B, C.
2. Shtetasi J. T., me arsim të mesëm dhe kategori të lejes së drejtimit B, C, D.
3. Shtetasi E. I., me arsim të mesëm dhe kategori të lejes së drejtimit B, C.

Pavarësisht faktit se, gjatë kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ndaj drejtuesve të autoambulancave, mbi konsumin e karburantit dhe ndërrimin e pjesëve të këmbimit, janë gjetur në shkelje edhe drejtues të tjerë të autoambulancave, ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë

Nga dokumentacioni dhe provat e administruara, rezulton i provuar fakti se ankuesi i ka kryer të gjitha shërbimet mjetit tip Volkswagen me targë AA 183 KY, të cilat janë të pasqyruara në faturën tatimore të lëshuar nga servisi përkatës dhe procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të këtij automjeti. Pavarësisht këtij fakti, edhe pse gjatë marrjes në dorëzim të automjetit nga servisi, kanë qënë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, nuk janë ngarkuar me përgjegjësi, por vetëm ankuesi.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm apo një justifikim të arsyeshëm dhe proporcional për largimin e ankuesit nga puna, konstaton trajtimin e pabarabartë dhe të pafavorshëm, duke marrë masën për largimin e tij nga puna në mënyrë të qëllimshme, të pajustificuar dhe të pa argumentuar ligjërisht.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁸ të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

⁸ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar për shkak të *bindjeve politike*, shkak i parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

“*Bindja Politike*” është shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Gjatë trajtimit të ankesës së A. B., bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim që prej vitit 2005, vërtetuar me anë të shkresës Nr. 2 prot., datë 20.04.2018, si dhe me anë të Kartës së Anëtarësimit Nr. 5098, datë 18.04.2016.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁹ dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Sipas informacionit të administruar në media¹⁰, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, A. D., i cili ka bërë largimin e ankuesit nga puna, është pjesë e strukturave të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për kuvend të vitit 2013 Partia Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë garuar së bashku në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, duke krijuar së bashku qeverinë. Në zgjedhjet për kuvend të vitit 2017 Partia Socialiste (PS) ka garuar dhe fituar zgjedhjet si forcë e vetme politike, pa prezencën e Lëvizjes Socialiste për Integrim në koalicion, duke kaluar si

⁹ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁰ <http://top-channel.tv/2019/06/30/skrapar-incident-ne-qendren-e-votimit-raportohet-per-te-lenduar/>
<http://www.corovodaonline.com/2013/11/ndryshimet-ne-administrate-adyrmishi-ne.html>
<https://www.newsbomb.al/e-pushoi-nga-puna-ish-drejtori-i-spitalit-sherr-me-shoferin-ne-qendren-e-votimit-ne-corovode-nje-i-plagosur-170524>

forcë politike opozitare këtë të fundit. Pas largimit nga koalicioni qeverisës i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, në Shërbimit Spitalor Skrapar është emëruar drejtuesi i ri i institucionit, A. D. Referuar ankesave¹¹ të paraqitura pranë KMD-së, për punonjësit të cilët janë anëtarë të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, me emërimin e A. D. në pozicionin e drejtuesit të Shërbimit Spitalor Skrapar, kanë nisur procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *"Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim "*, nuk lind nevoja për verifikim.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shërbimi Spitalor Skrapar:

- Pavarësisht faktit që gjatë marrjes në dorëzim të automjetit me targë AA 183 KY, nga servisi, kanë qënë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, asnjë prej tyre nuk është ngarkuar me përgjegjësi, por vetëm ankuesi.
- Komisioni për normën e konsumit të karburantit, i përbërë nga të njëjtët punonjës nga viti 2015 deri në vitin 2018, kanë vlerësuar të njëjtin konsum karburanti për 2 vite rradhazi, ndërsa me emërimin e A. D. në krye të Shërbimit Spitalor Skrapar, kanë ndryshuar qëndrim duke vlerësuar se autoambulanca që kishte në përdorim ankuesi ka një konsum më të ulët.
- Pavarësisht faktit që e njëjta autoambulancë është përdorur nga dy drejtues (shoferë), është penalizuar duke u larguar nga detyra vetëm ankuesi.

Në analizë të Vendimit Nr. 228, datë 14.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila është shprehur për: *"Pushimin e çështjes penale Nr. 228 rregj. Them., datë regjistrimi 13.05.2019, që i përket procedimit penal Nr. 306, datë 04.05.2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në ngarkim të shtetasit A. B. për veprat penale 'Vjedhja duke shpërdoruar detyrën' dhe 'Shpërdorimi i detyrës' të parashikuara në nenet 135 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak se fakti nuk ekziston"*, rezulton se asnjë nga pretendimet e ngritura ndaj shtetasit A. B., nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, nuk qëndrojnë dhe nuk janë të provuara.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se largimi i tij nga puna, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës

¹¹ A. B. dhe S. K.

tjetër/organit publik, në këtë rast Shërbimi Spitalor Skrapar. Pra, në këtë rast Shërbimi Spitalor Skrapar, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njihet dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹²

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja¹³ është shprehur se: *“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm.”*. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e

¹² https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

¹³ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës¹⁴.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar¹⁵, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa d) parashikohet se: “...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, **opinionit politik**, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁶. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

¹⁴ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹⁵ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

¹⁶ Referuar nenit 3, pika 8 ,e LMD-së.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit A. B. nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, për shkak të bindjeve politike.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e A. B. në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)